



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

UDHËZUES

PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ANËTARËT E KËSHILLIT GJYQËSOR NGA GJYQSORI

KREU I. RREGULLAT E PËRGJITHSHME

I. Baza Ligjore

- a. Ky Udhëzues është i bazuar në Rregulloren (Nr. 09/2019) për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori .

II. Shpallja e vendit të lirë

- a. Këshilli duhet të fillojë procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga gjyqësori tre (3) muaj para skadimit të mandatit të rregullt të anëtarëve për rastet e parapara sipas nenit 6, paragrafi 2, të Rregullores.
- b. Këshilli duhet të fillojë procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga gjyqësori jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita kur pozita mbetet e lirë për rastet e parapara sipas nenit 6, paragrafi , nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, dhe 3.6., të Rregullores.
- c. Këshilli shpall pozitën e lirë për anëtarë të Këshillit në ueb portal dhe përcakton se nga cili nivel i gjykatave duhet të zgjedhet anëtari, afatin kohor për dorëzimin e nominimit, kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm.

III. Procedura e aplikimit dhe e drejta e nominimit të kandidatëve gjyqtarë për anëtarë të Këshillit nga gjyqësori

- a. Të gjithë Gjyqtarët e interesuar për paraqitur nominimin e tyre për anëtarë të Këshillit nga gjyqësori duhet që në afat prej 15 ditësh nga dita e shpalljes së pozitës së lirë, të paraqesin në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dokumentacionin e nevojshëm sipas Ligjit dhe kërkesave sipas nenit 5 të rregullores Nr.09/2019 për Procedurën dhe kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori.

- b. Të gjithë gjyqtarët e gjykatave të Republikës së Kosovës kanë të drejtë të vetë nominohen si kandidatë për anëtarë të Këshillit.

IV. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit dhe lista përfundimtare e kandidatëve të nominuar

- a. Këshilli menjëherë pas shpalljes së pozitës së lirë themelon një Komision *ad hoc* të përbërë nga tre anëtarë të Këshillit i cili mbikqyrë procesin e zgjedhjes, përgjegjësitë e të cilit janë:
 - i. shqyrtimi i dokumentacionit;
 - ii. vlerësimi i plotësimit të kriterëve të kandidatëve të nominuar;
 - iii. përpilimi i listës përfundimtare të kandidatëve (në afat prej 5 ditëve)
 - iv. hartimi i raportit me shkrim rreth përshtatshmërisë së kandidatëve sipas kërkesave ligjore dhe kërkesave të nenit 5 të Rregullores; dhe
 - v. njoftimin e gjykatave për listë përfundimtare të kandidatëve të cilët kanë plotësuar kriteret dhe publikimin e listës në ueb portalin e Këshillit;
- b. Në rast se asnjëri nga kandidatët e nominuar nuk i plotëson kushtet procedura e nominimit përsëritet për kandidatë të tjerë nga të njëjtat gjykata;
- c. Komunikimi për datën dhe vendin e mbajtjes së zgjedhjeve bëhet përmes shpalljes publike në ueb portalin e Këshillit, për të gjithë gjyqtarët e gjykatave të Republikës së Kosovës. Nga gjykatat kërkohet të bëjnë shpalljen në tabelën e shpalljeve.

V. Procesi i zgjedhjes së kandidatëve për anëtarë nga Gjyakta Supreme dhe Gjykata e Apelit

- a. Pas pranimit të listës përfundimtare të kandidatëve të nominuar, Këshilli në afat prej dy (2) ditëve shpallë ditën e zgjedhjes;
- b. Shumica e thjeshtë e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës perkatese, respektivisht të Gjykatës së Apelit apo gjyqtarëve të Gjykatës Supreme duhet të jenë prezent për të votuar;
- c. Secili i nominuar do të ketë mundësinë të prezantoj jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) minuta në vizionin e tij/saj mbi punën e Këshillit dhe kontributin e tij/saj si anëtar;

- d. Zgjedhja e kandidatit për anëtarë të Këshillit bëhet me votim të fshehtë. Çdo gjyqtarë ka të drejtë vote. Kandidati i cili merr shumicën e votave, konsiderohet kandidatë i zgjedhur. Në rast të numrit të barabartë të votave, organizohet votimi i dytë në mes të kandidatëve me më së shumti vota, nëse edhe votimi i dytë përfundon me numër të barabartë të votave përsëritet procesi zgjedhor nga fillimi;
- e. Komisioni mbikqyrë procesin zgjedhor në gjykata, ndërsa Sekretariati i Këshillit ofron mbështetje administrative gjatë zhvillimit të kësaj procedure.

VI. Procedura e nominimit dhe e zgjedhjes kandidatëve për anëtarë të Këshillit nga Gjykatat Themelore

- a. Pas pranimit të listës përfundimtare të kandidatëve, Këshilli në afat prej dy (2) ditëve shpallë ditën e zgjedhjes;
 - b. Zgjedhja e kandidatit të nominuar nga gjykata perkatëse themelore bëhet me votim të fshehtë. Çdo gjyqtarë ka të drejtë vote. Kandidati i cili merr shumicën e votave, konsiderohet kandidatë i zgjedhur nga gjykata perkatëse për të marrë pjesë në tubimin zgjedhor. Në rast të numrit të barabartë të votave, organizohet votimi i dytë në mes të kandidatëve me më së shumti vota, nëse edhe votimi i dytë përfundon me numër të barabartë të votave përsëritet procesi zgjedhor nga fillimi;
- c. Pas përfundimit të zgjedhjeve në Gjykatat Themelore, Komisioni përpilon listën e të zgjedhurve nga gjykatat perkatëse si dhe njofton të gjithë gjyqtarët e Gjykatave Themelore në lidhje me kandidatët e zgjedhur dhe ditën e mbajtjes së procesit zgjedhor.
- d. Shumica e thjeshtë e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatave Themelore duhet të jenë prezent në proces zgjedhor për votim.
- e. Secili kandidat i zgjedhur do të ketë mundësinë të prezantoj jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) minuta në vizionin e tij/saj mbi punën e Këshillit dhe kontributin e tij/saj si anëtar.
- f. Pas prezantimeve fillon procesi i votimit të mbyllur ku secila Gjykatë Themelore do të ketë kutinë e veçantë të votimit.
- g. Asnjë Gjykatë Themelore nuk mund të ketë më tepër se një përfaqësues të zgjedhur nga gjyqësori në Këshill, gjatë të njëjtit mandat.
- h. Gjyqtarët e të gjitha Gjykatave Themelore votojnë për gjyqtarët e nominuar.
- i. Zgjedhja e kandidatit për anëtarë të Këshillit bëhet me votim të fshehtë. Çdo gjyqtarë ka të drejtë vote. Varësisht nga numri i anëtareve të cilët duhet zgjedhur, kandidati i cili

e merr shumicën e votave, konsiderohet kandidatë i zgjedhur. Në rast të numrit të barabartë të votave, organizohet votimi i dytë në mes të kandidatëve me më së shumti vota, nëse edhe votimi i dytë pëfundon me numër të barabartë të votave përsëritet procesi zgjedhor nga fillimi .

- j. Komisioni mbikqyrë procesin zgjedhor në gjykata, ndërsa Sekretariati i Këshillit ofron mbështetje administrative gjatë zhvillimit të kësaj procedure.

VII. Mandati dhe përgjegjësitë e Këshillit dhe Komisioneve të tjera në procesin zgjedhor

- a. Këshilli ka mandat që të bëjë shpalljen e pozitave të lira për anëtarët e Këshillit nga gjyqësori, dizajnimin dhe miratimin e formatit të materialit zgjedhor, të shpallë rezultatin zgjedhor, të vendos për përsëritjen e procesit zgjedhor dhe të certifikojë rezultatin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga gjyqësori.
- b. Këshilli cakton komisione që të organizojnë dhe mbikëqyrin procesin dhe mbarëvajtjen e proceduarve të zgjedhjes dhe votimit në nivel të gjykatave. Komisionet do të jenë të përbëra prej tre (3) anëtarëve të Këshillit.
- c. Komisionet janë përgjegjëse për administrimin dhe mbikëqyrjen e gjithëmbarshme të aktiviteteve rreth zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga gjyqësori në bazë të këtyre procedurave dhe veprimeve, por nuk do të kufizohen në:
 - 1.1. Numrimin e votave;
 - 1.2. autorizimin e stafit përkatës administrativ të Këshillit për t'i ndihmuar rreth administrimit efektiv të procesit zgjedhor;
 - 1.3. hartimin, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e listës së gjyqtarëve që do të marrin pjesë në procesin zgjedhor;
 - 1.4. raportimin e detajuar për Këshillin për procesin dhe rezultatin zgjedhor;
 - 1.5. ndërmarrjen dhe kryerjen e veprimeve tjera të përshtatshme për administrimin dhe mbikëqyrjen e gjithëmbarshme të procesit zgjedhor.
- d. Gjyqtarët të cilët votojnë identifikohen me letërnjoftim.
- e. Zyrtari i autorizuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i cili ndihmon Komisionin, ngarkohet me mbajtjen e shënimeve zyrtare të procedurës së zgjedhjes.

VII. Materialet votuese

- a. Materiali votues përfshin fletët e votimit, Listat e gjyqtarëve, Formularin e raportimit, kutitë dhe kabinetat e votimit.

- b. Materiali votues do të dërgohen në vendin ku bëhet votimi në ditën e zgjedhjeve nga zyrtari i autorizuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i cili ndihmon Komisionin.
- c. Pjesë e materialit votues do të jenë edhe listat me emrat e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës përkatëse të cilat do të ndahen për çdo gjykatë.

VIII. Fletëvotimet

- a. Këshilli do të përgatitë dhe aprovojë fletëvotimet jo më vonë se shtatë (7) ditë para ditës së zgjedhjeve.
- d. Zyrtari i autorizuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i cili ndihmon Komisionin do të dorëzojë fletëvotimet në vendvotim në ditën e zgjedhjeve.

IX. Lista e Gjyqtarëve

- b. Secili gjyqtar i cili voton do të nënshkruhet në Listën e gjyqtarëve, pas identifikimit nga Komisioni dhe marrjes së fletëvotimit.
- c. Lista e nënshkruar e gjyqtarëve ruhet si material dhe dorëzohet në Këshill së bashku me materialin tjetër votues.

X. Formulari i raportimit

- a. Formulari i raportimit do të shërbejë për qëllime të verifikimit dhe auditimit, dhe duhet të plotësohet nga zyrtari i autorizuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i cili ndihmon Komisionin
- b. Formulari i raportimit duhet të tregojë numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve që kanë votuar dhe numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të papërdorura.
- c. Formulari i raportimit do të tregojë gjithashtu çdo lloj shkelje të rregullores apo pengese të paraqitur gjatë procesit të votimit.

XI. Kutitë e votimit

- a. Kutitë e votimit duhet të jetë transparente dhe e zbrazëta.

XII. Fletëvotimet e papërdorura

- a. Të gjitha fletëvotimet e papërdorura do të kthehen në Këshill për qëllime të verifikimit eventual.

XIII. Fletëvotimet e pavlefshme dhe të paplotësuara

- a. Një fletëvotim do të konsiderohet i pavlefshëm nëse:
 - i. ka më shumë se një gjyqtar të votuar / shënuar në fletëvotim; ose

- ii. mënyra e të shënuarit në fletë votim tregon qëllimin e paqartë të votuesit.
- b. Një fletëvotim që nuk është plotësuar farë konsiderohet si fletë votim i paplotësuar.

XIV. Numërimi i votave

- a. Fletëvotimet numërohen nga Komisioni në përbërje të plotë;

XV. Raporti i Komisionit

Pasi që Komisioni të ketë përfunduar procesin e numërimit të votave që konsiderohen si të vlefshme dhe shpall rezultatet, atëherë Komisioni do të përgatitë një raport me shkrim i cili do të dorëzohet tek Këshilli. Raporti do të përmbajë:

- i. Listën me emrat e gjyqtarëve për të cilët janë numëruar votat;
- ii. Numri i votave që ka marrë secili/a gjyqtar/e;
- iii. Numrin e fletë votimeve të konstatuara si të pavlefshme; dhe
- iv. Emrat e gjyqtarëve të ri të zgjedhur për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

XVI. Certifikimi i rezultateve

- a. Pasi që numërimi i votave të ketë përfunduar, në prani të përbërjes së plotë të Komisionit, anëtarët do të raportojnë me shkrim tek Këshilli për procesin dhe rezultatin zgjedhor.
- b. Këshilli do të certifikoj rezultatin zgjedhor për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe do të publikojë atë në faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

XVII. Lista e gjyqtarëve me të drejtë vote

Gjykata Supreme

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata e Apelit

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Prishtinës

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Prizrenit

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Gjakovës

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Gjilanit

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Mitrovicës

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Pejës

- Lista e gjyqtarëve

Gjykata Themelore e Ferizajt

- Lista e gjyqtarëve